



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/17/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë Albina Shabani Rama, duke shqyrtuar ankesën e ushtruar nga N.H ndaj gjyqtarit A.G, për të vendosur për çështje disiplinore, në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 12.08.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga N.H ndaj gjyqtarit A.G, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës N.H përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 11.07.2024 përmes adresës elektronike ka parashtruar ankesë për gjyqtarin A.G. Ankesa është përcjellë te Autoriteti Kompetent me datë 15.07.2024.

Parashtruesi i ankesës në ankesën disiplinore të paraqitur përmes adresës elektronike ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë të ndërmarrin masa ligjore ndaj gjyqtarit A.G, pasi që me datë 07.02.2023 ka qenë i angazhuar në trajtimin e rastit tek shkolla fillore “ Pavarësia” në Prishtinë, në një rast të rrahjeve të disa nxënësve, ku sipas tij pasi që kanë shkuar dhe janë takuar me personat kompetent të shkollës duke ju treguar edhe videot të cilat i kanë poseduar, ku shiheshin disa nxënës duke e sulmuar një nxënës tjetër me grushte dhe shkelma., të njëjtit i kanë identifikuar nxënëset sulmuese, ku njëra ndër to ka qenë nxënësja B.G, mirëpo sipas tij gjatë trajtimit të rastit është hasur një rezistencë nga prindërit e të njëjtës z. A dhe D.G të cilët kanë penguar në kryerjen e detyrave zyrtare. Sipas parashtruesit të ankesës gjatë gjithë intervistimit të nxënësës B.G, prindi A.G vazhdimisht deklaronte se është gjyqtar në gjykatë dhe pengonte në zhvillimin e intervistës m vajzën e tij, duke ndërhyrë në përgjigje të pyetjeve që i parashtronim dhe duke ngritur zërin ndaj policëve. Sipas tij, A dhe D. G. janë acaruar aq shumë duke filluar edhe në fyerje dhe sharje ndaj policëve present, ku në një moment D.G ka deklaruar se “ unë gjallë, vajza ime nuk ka me shku në paraburgim, unë do të ja marrë revolen zyrtarit policor dhe do të bëjë vetëvrasje këtu në stacion”. Në këtë rast, sipas tyre në mënyrë që të mbajnë situatën nën kontroll janë detyruar që të kërkojnë asistencë shtesë.

Në lidhje me pretendimet e parashtruara në këtë ankesë, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se Pretendimet e “ankuesit si zyrtarë policorë” nuk mund të quhen ndryshe vetëm si hakmarrje e ndaj tij dhe bashkëshortes time për procedurat që ka inicuar bashkëshortja ndaj tij pranë IPK-së me datën 07.02.2024 rreth mesnatës përmes thirrjes në numrin kujdestar të IPK-së dhe të nesërmen me shkrim me datën 08.02.2024 në mëngjes.

Sipas tij, vet fakti që pas 5 muaj e 4 ditë prej datës 07.02.2024 gjer me datën 11.07.2024 zyrtari policorë në fjalë e ka paraqit “ankesën” direkt në KGJK është hakmarrje personale për procedurat e lartëcekura ndaj tij në IPK dhe në standarde profesionale e për të cilat paraprakisht ishte njoftuar si më lartë, e duke e shkelur hierarkinë policore duke iu drejtuar direkt KGJK-së.

Tutje ka deklaruar se “Ankuesi” është “zyrtarë policorë” ku sipas Nenit 9 par. 1 të Ligjit Nr. 06/L - 057 nuk ka të drejtë të paraqet “ankesë” në KGJK për një gjyqtar që ka shkuar në stacion policor për çështje tjera si më poshtë. Po ashtu, i njëjti nuk ka të drejtën të marrë rolin edhe të interpretuesit të Ligjit. Nëse nuk është hakmarrje apo po të qëndronin seriozisht pretendimet e tij, pse nuk e bëri “njoftimin policor” menjëherë por pas 18 orëve, pse priti 5 muaj e 4 ditë të paraqes “ankesë direkt në KGJK” dhe jashtë hierarkisë policore, asgjë nuk e ka penguar. Është e qartë që janë hakmarrje e tij e që nuk duhet të lejohen, dhe propozojë që të refuzohen sepse “pretendimet e tij” nuk qëndrojnë.

Sipas tij, Në stacion policor bashkë me bashkëshorten kanë shkuar në cilësinë e prindërve-përfaqësuesve ligjor dhe për mbrojtjen e të drejtave të fëmijut të tyre të mitur që është obligim ligjor dhe kushtetutes pavarësisht pozitës. I njëjti ka deklaruar se nuk do të thotë që asnjë fëmijë i ndonjë zyrtari të mos bëjë gabime, e për këtë nuk duhet të paragjykoen nga policët. Pse është ndaluar një fëmijë i një gjyqtari nuk do të thotë se gjyqtari ka bërë sjellje apo veprime që kanë penguar apo keqpërdor detyrën në ato vendime apo procedura.

Tutje ka vazhduar se Ankuesi si zyrtarë policor” duke u thirrur në “titullin zyrtarë policor” ka pasur sjellje arrogante ndaj familjes së tij, duke mos u kursyer në prezencë të fëmijut të mitur, duke e ofenduar dhe paragjykuar dhe duke mos respektuar parimin e supozimit të pafajësisë, dhe pse e ka obligim që të kujdeset për shëndetin më të mirë të fëmijës dhe që intervistimi të jetë sa më pak i dëmshëm dhe sa më i shkurtër për fëmijun e sidomos kur që në fillim është pranuar gabimi. Të gjitha sjelljet e tilla të një “zyrtari policor” sidomos ndaj fëmijut të mitur kanë ndikim shumë të keq në të mitur për të ardhmen, e këto ai “zyrtarë policor” as që i ka pasur në konsideratë.

Po ashtu, në stacion, edhe atë në hyrje të stacionit por edhe brenda stacionit sipas tij policët e kanë njohur sepse ka punuar 5 vite si prokurorë në tri regjione të mëdha në Kosovë ndër to edhe në PTH Prishtinë, ashtu që sipas tij nuk ka pasur nevojë të thirret në pozitën e tij si gjyqtar. Tutje ka deklaruar se në shkollë nuk kam nevojë të thirrem në pozitën time zyrtare sepse i kam të drejtat si prind pa pasur nevojë për këtë pozitë.

Tutje gjyqtari ka deklaruar se “Ankuesi si zyrtarë policorë” edhe pasi që kanë dalur nga stacioni policor e ka ofenduar rëndë fëmijën e tij duke i thënë se “apo e sheh edhe fëmijët e gjyqtarëve i shtijmë në burg”, dhe të tjera fjalë që i njëjti nuk i ka potencuar në deklaratën e tij.

Gjyqtari A.G po ashtu ka deklaruar se po të ishte ashtu siç pretendon “ankuesi-zyrtari policorë” në shenjë hakmarrje: së pari fëmiju i tij nuk do të deklarohej por do të mbrohej në heshtje, por për 6 orë një e mitur është mbajte në stacion e ndër to rreth 1 orë deklarim fillestar për ngjarjen

dhe pastaj rreth 2 orë i janë parashtruar pyetje edhe pse ishte pranuar veprimi në fillim. Përkundrazi, sipas tij fëmija i tij i mitur është përgjigjur në të gjitha pyetjet e atij “zyrtari policor” mirëpo zyrtarit policor nuk i pëlqenin përgjigjet. Sipas tij, në lidhje me këtë rast nuk ka përdorur pozitën e tij pasi që nuk ka nxjerrë asnjë vendim si dhe nuk ka përdorur pozitën e tij që të ndikoj në pyetjet e bëra nga ana e zyrtarit policor, si dhe sipas tij me zyrtarin policor është sjellur shumë mirë.

Për fund ka deklaruar se në stacion policorë ka shkuar për çështje private, nuk është sjellë jashtë të drejtave të ti si prind-përfaqësues ligjor apo kundër pozitës së tij si gjyqtar, as nuk ka penguar askënd as para vendimit për ndalim e as pas, apo keqpërdorë detyrën. Njëherit, ka kërkuar që këto çështje të mbahen konfidenciale për shkak të fëmijës së tij të mitur.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.G.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Nuk është kontestuese fakti se gjyqtari A.G ka qenë prezent në Stacionin Policor Jugu në Prishtinë me datë 07.02.2024 si përfaqësues ligjor i fëmijës së tij të mitur B.G, fakt ky i cili është deklaruar edhe nga gjyqtari i çështjes. Mirëpo, për Autoritetin Kompetent është e rëndësishme gjetja e shkeljeve të detyrave të tij zyrtare si gjyqtar të cilat përkojnë me sjelljet e tij jashtë ambienteve të gjykatës.

Autoriteti kompetent me kujdes dhe përkushtim të veçantë analizoj të gjitha deklaratat e mësipërme si të vetmet prova në këtë procedurë disiplinore dhe në vlerësim të prezencës së gjyqtarit A.G në Stacionin Policor Jugu në cilësinë e prindit të të miturës B.G, ka gjetur se i njëjti është paraqitur në stacionin policor sipas njoftimit që prindërve ju është bërë me rastin e intervistimit të fëmijës së tyre të mitur, ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi.

Fakti se prindi mund të jetë me profesion gjyqtar, a po prokuror, a po edhe zyrtar policor, nuk e liron nga detyrimi që prindërit kanë për fëmijët e tyre të mitur a po madhor, respektivisht detyrimin ligjor që të marrin pjesë në marrjen në pyetje të fëmijës së tyre në procedurat paraprake, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të fëmijës.

Përtej rrethanave të lartcekura, autoriteti kompetent me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të vërtetojë se gjyqtari A.G ka përdorur në çfarëdo mënyre pozitën a po autoritetin e tij si gjyqtar që të ndikoj në zhvillimin e hetimeve a po marrjen e vendimit nga ana e institucioneve përkatëse. Nga deklarata e zyrtarit policor dhe vetë gjyqtarit, në asnjë mënyrë dhe me asnjë provë nuk u argumentua se gjyqtari në fjalë me paraqitjen e tij në stacion policor ka ndërmarrë ndonjë veprim, ka ndërhyrë apo ka penguar procesin e hetimit.

Pretendimet ankimore se gjyqtari A.G ka penguar në kryerjen e detyrave zyrtare, janë pretendime të pambështetura në ndonjë provë materiale, ku mund të përmendim këtu edhe faktin se kjo ankesë është dorëzuar me rreth 6 muaj pas pretendimit për zhvillim të këtij rasti.

Pretendimet se gjyqtari A.G ka qenë insistues që të dijë emrin dhe mbiemrin e zyrtarëve policor, a po se ka ndërhyrë në pyetjet që i janë parashtruar fëmijës së tij të mitur, nuk mund të jenë pretendime për fillim të procedurës disiplinore, pasi që këto të drejta të njëjtit si përfaqësues ligjor i burojnë nga ligji.

Në këtë pikë, autoriteti kompetent vlerësoj parimet e përgjithshme dhe rregullat e sjelljes që dalin nga Kodi i Etikës për Gjyqtar dhe gjeti se me marrjen përsipër të titullit gjyqtar, me të vërtetë që të njëjtit si bartës të një funksioni të rëndësishëm publik janë të obliguar që të ruajnë dhe promovojnë sjellje të lartë profesionale, duke u përmbajtur nga sjelljet që ngritin dyshimet e opinionit publik në paanshmërinë apo besueshmërinë e vetë gjyqtarit dhe të gjyqësorit në përgjithësi, megjithatë pavarësisht faktit se gjyqtari pranon kufizimet që i imponon funksioni që ushtron, normat e sjelljes etike që burojnë nga titulli që bartë nuk e zhveshin nga ndjenja njerëzore dhe nga fakti i të qenit familjar.

Andaj, mbi dinamikën e tillë të rrjedhës së ngjarjes, autoriteti kompetent gjeti se me faktin e paraqitjes së gjyqtarit në cilësinë e prindit – përfaqësuesit ligjor në stacionin policor ku ka qenë në ndalim/marrje në pyetje fëmija i tij i mitur, e në mungesë të provave që vërtetojnë se i njëjti ka shfrytëzuar autoritetin e tij si gjyqtar në interes të familjarëve të tij, gjyqtari A.G nuk e ka dëmtuar dinjitetin, pavarësinë apo paanshmërinë e tij apo të gjyqësorit andaj i njëjti nuk është përfshirë në veprime që hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore të përcaktuara me nenin 5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/17/24, me datë 12.08.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë